



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
I SANKSIONEVE

Data: 6 Korrik 2021

Nr: 99

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 58, PARAQITUR NË
KQZ NË DATËN 05.07.2021

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 06.07.2021, me pjesëmarrjen e:

Koli BELE - Relator
Elvin LAKO - Anëtar
Elvis ÇEFA - Anëtar
Ilirjan RUSMALI - Anëtar
Ledio BRAHO - Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Partia Demokratike e Shqipërisë;

OBJEKT: Kundërshtimi i vendimit nr. 422, datë 02.07.2021 të KSHZ “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues z. Qerim Ismailaj, kryetar i Bashkisë Mallakastër, Qarku Fier.

BAZË LIGJORE: Nenet 21, 123/1, 124, 126, 129, 130 dhe 131 të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 17 dhe 18 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” të Komisionit Rregullator.



Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Partia Demokratike e Shqipërisë ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 58 regj., datë 05.07.2021.

Në mbledhjen e datës 06.07.2021, ora 12:00, pas relatimit të z. Koli Bele u konstatua se kërkesa ankimore nr. 58 nuk i plotësonte elementët e përcaktuara në shkronjën “a”, të nenit 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Dy anëtar të KAS-it përkatësisht z. Koli Bele dhe z. Elvin Lako konstatojnë se nuk është kompetencë e KAS-it shqyrtimi i kërkesës ankimore nr.58 me objektin e sipërcituar. KAS-i ka kompetencë lëndore të veçantë, çështjet që lidhen në mënyrë ekskluzive me zbatimin e ligjit zgjedhor dhe jo ato që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjeve të tjera të veçanta, siç është në rastin në fjalë, vendimmarrja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Shumica e anëtarëve të KAS-it konstatojnë se kërkesa ankimore nr.58 i plotëson elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, të Komisionit Rregullator, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 126 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 17, pika 3, shkronjat “a” e 18, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” të Komisionit Rregullator,



VENDOSI:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 58, datë 05.07.2021, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 7 Korrik 2021, në orën 10:00.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Koli	BELE	-	Relator	(Kundër)
Elvin	LAKO	-	Anëtar	(Kundër)
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar	
Iirjan	RUSMALI	-	Anëtar	
Ledio	BRAHO	-	Anëtar	



MENDIM PAKICE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve është krijuar si një nga organet drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 101 datë 23.07.2020 në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. Në përputhje me nenin 12, pika 5 e Kodit Zgjedhor, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) është organi kompetent për shqyrtimin e ankimeve administrative dhe për vendosjen e sanksioneve **për shkelje të ligjit zgjedhor**. Ky organ funksionon me kohë të pjesshme dhe sipas nenit 21 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar ka këto kompetenca:

- vendos shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve ose përsëritjen e tyre;
- shqyrton dhe zgjidh në rrugë administrative ankesat ndaj akteve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
- shqyrton dhe zgjidh në rrugë administrative ankesat e subjekteve zgjedhore ndaj vendimeve të KZAZ-ve;
- vlerëson performancën e komisionerëve dhe numëruesve;
- vendos masa disiplinore ndaj zyrtarëve zgjedhorë kur konstatohen shkelje ose parregullsi në administrimin e materialit zgjedhor;
- vendos sanksione administrative kundër personave që kryejnë kundërvajtje administrative në lidhje me zgjedhjet.

Në kuptim të nenit të sipërcituar, KAS-i ka kompetencë lëndore të veçantë të lidhur me shqyrtimin e çështjeve që lidhen në mënyrë ekskluzive me zbatimin e ligjit zgjedhor. Në këtë kuptim, nuk është në kompetencë të KAS shqyrtimi i çështjeve që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjeve të tjera të veçanta, siç është në rastin në fjalë ligji nr. 138/2015 ‘*Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*’.

Referuar vendimit me Nr. 00-2018-1028 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë: ‘vërehet se mosmarrëveshja konkrete nuk buron nga procesi zgjedhor por nga ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. (...) Edhe pse, mbështetur në përmbajtjen e këtij ligji (neni 10), kompetencat vendimmarrëse në lidhje me mandatin e deputetëve të Kuvendit që preken nga zbatimi i tij, i janë dhënë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ky i fundit, në këtë rast, nuk vepron si organ i administrimit të procesit zgjedhor.

Gjithashtu, bazuar në arsyetimin e Gjykatës së Lartë në vendimin e sipërcituar, kompetenca lëndore e KAS do të shtrihet vetëm për mosmarrëveshjet që lindin nga procesi zgjedhor (kundërshtimi i vendimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në lidhje me administrimin e procesit zgjedhor). Asnjë mosmarrëveshje tjetër, qoftë edhe kur buron nga vendimmarrja e këtij organi publik (Komisioneri



Shtetëror i Zgjedhjeve), por jo në kuadër të procesit zgjedhor, nuk mund t'i atribuohet kompetencës lëndore të KAS. Kompetenca e tij, duke qenë ekskluzive, duhet të interpretohet në mënyrë të ngushtë dhe fokusohet vetëm në mosmarrëveshjet zgjedhore.

Sipas arsytimit të mësipërm të shkëputur nga vendimi i Gjykatës së Lartë, në vendimmarrjen e tij “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjigjeshme për subjektin vetëdeklarues z. Qerim Ismailaj, kryetar i Bashkisë Mallakastër, Qarku Fier”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk ka vepruar në kuadër të ligjit zgjedhor dhe për pasojë vendimet e tij lidhur me këtë proces nuk duhet të ankimohen në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, por në Gjykatën Administrative, si organi gjyqësor kompetent për shqyrtimin e të gjitha mosmarrëveshjeve administrative, me përjashtim të atyre që me ligj janë në kompetencë të organeve të veçanta.

Për sa më sipër, ne anëtarët në pakicë vlerësojmë se Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve duhej të vendoste mospranimin e kërkesës ankimore nr. 58, datë 05.07.2021, për shkak të mosrespektimit të shkronjës “a”, të nenit 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, për shkak se KAS-i nuk është organi kompetent për shqyrtimin e ankimit.

Koli BELE **Relator**

Elvin LAKO **Anëtar**

